

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pkl-Kzz 69/2010

03 maj 2011

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit, me gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës Emine Mustafa dhe Marije Ademi si anëtare të kolegjit, dhe në praninë e Këshilltarit Ligjor Adnan Isufi si procesmbajtës, në lëndën penale Pkl-Kzz nr 69/2010 të Gjykatës Supreme të Kosovës,

Kundër të pandehurit **Ramadan Sulejmani**,

mbrojtur nga avokati mbrojtës ligjor

Si pandehur i veprave penale të

Ko-

ndërkombëtare të terrorizmit, në veçanti,

si

**I dënuar në shkallën e parë** me aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit, të datës 06 qershor 2010, P. Nr. 697/09 për kryerjen e veprave penale

**Dhënia e kundërligjshme e ndihmës juridike**, në kundërshtim me nenin 336 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK);

**Mashtrim**, në kundërshtim me nenin 261 paragrafi 1 i KPK;

**Mashtrim**, në kundërshtim me nenin 261 paragrafi 2 i KPK;

**Dhe i dënuar me një afat unik prej një (1) viti dhe tetë (8) muaj burgim;**

**I dënuar në shkallën e dytë** me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit për kryerjen e veprave penale

**Mashtrim**, në kundërshtim me nenin 261 paragrafi 1 i KPK dhe

**Mashtrim**, në kundërshtim me nenin 261 paragrafi 2 i KPK;

Ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Prizrenit në lidhje me pikën e tij të parë mbi **Dhënia e kundërligjshme e ndihmës juridike**, në kundërshtim me nenin 336 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK) është shfuqizuar dhe lënda është kthyer mbrapa për rigjykim;

**Duke vepruar sipas Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë** të paraqitur nga i pandehuri, e datës 16 korrik 2009, drejtuar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit (Ap.nr. 134/2010, të datës 12 tetor 2010), dhe nga avokati mbrojtës në emër të pandehurit të datës 27 tetor 2010, drejtuar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale të

Prizrenit (P.nr. 679/09) dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit (Ap.nr. 134/2010, të datës 12 tetor 2010),

lëshon këtë:

## AKTGJYKIM

*Kërkesa e mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë e datës 27 tetor 2010, dhe Kërkesa e të pandehurit për Mbrojtje të Ligjshmërisë, e datës 3 nëntor 2010, të dyja të drejtuara kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren (P.nr. 679/09) dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren (Ap.nr. 134/2010, të datës 12 tetor 2010) janë*

***refuzuar si të papranueshme,***

*për atë që ato janë të drejtuara kundër veprave penale në pikën I të aktgjykimeve mbi Dhënie e kundërligjshme të ndihmës juridike në kundërshtim me nenin 336 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK);*

*sa i përket pjesëve të tyre të mbetura, të dy Kërkesat për Mbrojtjen e Ligjshmërisë janë*

***refuzuar si të pabazuara,***


*për pikat II dhe III të dy aktgjykimeve të kundërshtuara për Mashtrim në kundërshtim me nenin 261 paragrafi 1 dhe 2 i KPK.*

## ARSYETIM

### I. Historia e Procedurës

(1) Prokurori Komunal në Ferizaj paraqiti një aktakuzë kundër të pandehurit me datë 22 korrik 2008 (PP.nr.856/08), për shkak të veprave penale Dhënie e kundërligjshme e ndihmës juridike sipas nenit 336 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës të kryer në vazhdimësi dhe Mashtrim sipas nenit 261 paragrafi 1 si edhe Mashtrim sipas nenit 261 paragrafi 2 i KPK, në bashkim real me veprat penale të përmendura nën pikat I dhe II të aktakuzës;

(2) Gjykata Komunale në Prizren me aktgjykimin e datës 6 qershor 2010, P. nr. 697/09, shpalli të pandehurin fajtor për kryerjen e veprave penale Dhënie e kundërligjshme e ndihmës juridike në kundërshtim me nenin 336 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK); Mashtrim, në kundërshtim me nenin 261 paragrafi 1 të KPK-së dhe Mashtrim, në kundërshtim me nenin 261 paragrafi 2 të KPK-së; i pandehuri ishte dënuar me një dënim unik prej një viti (1) dhe tetë (8) muaj;



(3) I pandehuri si dhe avokati i tij mbrojtjes në kohë kanë ankimuar aktgjykimin përkatëse të shkallës së parë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike dhe vendimit për dënimin, duke propozuar për ndryshimin e aktgjykimit të kundërshtuar dhe lirimin e të pandehurit nga të gjitha akuzat, apo të anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe kthej lëndën prapa për rigjykim, apo modifikoj aktgjykimin e kundërshtuar, duke shqiptuar një dënim më të butë për të pandehurin;

(4) Më 18 gusht 2010 në përgjigjën e tij (PPA.nr.131/2010) Prokurori Publik i Qarkut propozoi për të refuzuar të dy ankesat si të pabazuara dhe në tërësi të vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë.

(5) Me aktgjykimin Ap. Nr.134/2010 të datës 12 tetor 2010 Gjykata e Qarkut në Prizren shpalli të pandehurin fajtor për kryerjen e veprave penale Mashtrim, në kundërshtim me nenin 261 paragrafi 1 të KPK-së dhe Mashtrim, në kundërshtim me nenin 261 paragrafi 2 i KPK për pikat II dhe III të aktakuzës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren në lidhje me pikën I të aktakuzës për Dhënie të kundërligjshme të ndihmës juridike, në kundërshtim me nenin 336 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), u shfuqizua dhe lënda u kthye në shkallën e parë për rigjykim;

(6) Më 16 korrik 2009 i pandehuri ka paraqitur një Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë kundër të dyve, aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren të datës 6 qershor 2010, P. nr. 697/09, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ap. Nr. 134/2010 të datës 12 tetor 2010, duke kundërshtuar të dy aktgjykimet për shkelje të ligjit penal, shkelje esenciale të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale dhe i propozoi Gjykatës Supreme të Kosovës për të rishikuar provat e paraqitura në Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë për aktgjykimin e dhënë nga Gjykata e Qarkut të Prizrenit dhe për të modifikuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe të Qarkut në Prizren, të liroj atë nga të gjitha akuzat dhe të dërgojnë lëndën prapa në Gjykatën Komunale për rigjykim;

(7) Më 27 tetor 2010, po ashtu avokati mbrojtës i të pandehurit ka paraqitur Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, duke kundërshtuar të dy aktgjykimet për shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale të nenit 403 paragrafi 1 të KPPK dhe shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, si dhe për shkelje të ligjit penal dhe propozon të prishen të dy aktgjykimet; për më tepër, i pandehuri propozoi të shtyhet ekzekutimi i aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut deri sa Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë të vendoset.

(8) Më 10 nëntor 2010, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) paraqiti një propozim Gjykatës Supreme të Kosovës dhe propozoj për të refuzuar të dy Kërkesat për Mbrojtjen e Ligjshmërisë kundër aktgjyqimeve të kundërshtuara të Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut në Prizren si të pabazuari për pikat II dhe III të aktgjyqimeve dhe të hedh poshtë të dy kërkesat si të papranueshme, për aq sa ato janë

të drejtuara kundër veprave penale në pikën I të aktgjyqimeve, që ky i fundit nuk do të jetë përfundimtar.

(9) Më 2 mars 2011 i pandehuri kërkoi që EULEX-it të marrë lëndën, e që kjo e fundit u pranua nga Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it.

## II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme konstaton si më poshtë:

### I. Pranueshmëria e Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë

Kërkesat për Mbrojtjen e Ligjshmërisë janë të pranueshme, për aq sa ato janë të drejtuara kundër aktgjyqimeve të Gjykatës Komunale dhe Gjykatës së Qarkut në Prizren në lidhje me pikat II dhe III të aktgjyqimeve përkatëse.

Neni 451 i KPPK relevantë në lëndën në fjalë parasheh si vijon:


(1) *Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë [...] mund, të paraqitet [...] pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë.*

(2) ...

Komentet mbi ligjin e vjetër, në veçanti mbi nenin 416 të Ligjit Jugosllav mbi Procedurën Penale (LPP), i cili në lidhje me propozimin e mbrojtjes së ligjshmërisë të paraqitur nga prokuroria bënte fjalë rreth “vendimeve efektive”, pajtohen për interpretimin se “*propozimi për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet [...] por gjithmonë nën kushtin se është çështje e procedurave të realizuara në mënyrë efektive në çdo fazë apo etapë të procedurës*” (Brank Petric; *Komenti për Ligjin e Procedurës Penale; 1986; botimi i 2të, Gazeta Zyrtare e RSFJ; Beograd; Neni 416, pika II.4.*) që do të thotë se “*propozimi është i duhur vetëm në qoftë se shkelja e ligjit nuk mund të korrektohet përmes çfarëdo mjeti tjetër juridik*” (Momcilo Grubac & Tihomir Vasiljevic; *Komenti për Ligjin e Procedurës Penale; 1986; botimi i 2të, “Savremena Administracija” Beograd; neni 416, pika (7) në lidhje me Gjykatën Supreme të Kroacisë Kzz 6/78 të datës 15 shkurt 1978.*)

E njëjta vlen për mjetin e jashtëzakonshëm ligjor të pandehurve ‘*të cilët kanë qenë të dënuar në mënyrë efektive me një dënim me burg*’ dhe të cilët ‘*mund të paraqesin kërkesë për një rishikim të jashtëzakonshëm të një aktgjykimi të efektshëm*’, sipas nenit 425 paragrafi I të LPP.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke pasur parasysh dispozitivin e aktgjyqimit të kundërshtuar të Gjykatës së Qarkut, në rastin në fjalë e kupton se përmes këtij të



fundit, aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Prizrenit u anulua për pikën e tij I në lidhje me akuzën për Dhënie të kundërligjshme të ndihmës juridike sipas nenit 336 të KPK-së, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komunale u konfirmua në pjesët e saj të mbetur, që do të thotë akuzat dhe dënimi për Mashtrim sipas nenit 261 paragrafët 1 dhe 2 të KPK. Ky i fundit në veçanti del nga fakti se Gjykata e Qarkut ka ndërtuar një dënim të ri unik, duke pasur parasysh dy aspektet e miratuara të aktgjykimit të Gjykatës Komunale.

kurse aktgjykimi i Gjykatës Komunale është konfirmuar në pjesën e mbetur, që do të thotë akuzat dhe dënimi për Mashtrim sipas nenit 261 paragrafëve 1 dhe 2 të KPK-së. Kjo e fundit në veçanti sqaron faktin se Gjykata e Qarkut ka caktuar një dënim të ri unik duke i pasur parasysh dy aspektet e mbështetura të aktgjykimit të Gjykatës Komunale.

Për arsye të njëjta, kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të papranueshme pasi që janë të drejtuara kundër pikës I të aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës Komunale, sepse kjo e fundit është anuluar dhe është kthyer në rigjykim nga Gjykata e Qarkut. Prandaj, kjo pjesë e lëndës nuk është ende e formës së prerë dhe deri më tani nuk janë shfrytëzuar të gjitha mjetet e rregullta juridike.

Sa i përket pjesëve të mbetura, të dy kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë paraqitur pranë gjykatës kompetente sipas nenit 453 të KPPK-së dhe brenda afatit sipas nenit 452 paragrafit 3 të KPPK-së.

## **2. Procedura e ndjekur nga Gjykata Supreme**

Kolegji i Gjykatës Supreme ka vendosur në seancë siç përcaktohet me nenin 454 paragrafin 1 të KPPK-së. Palët nuk janë njoftuar për seancën pasi që sipas neneve 451 deri 460 të KPPK-së, Gjykata Supreme nuk është e obliguar që t'i njoftoj palët.


## **3. Mbi meritat e Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë**

### **a. Shkeljet esenciale të procedurës penale:**

#### **aa. Shkelja e pretenduar e nenit 403 paragrafit 1 pikë 12 të KPPK-së:**

Mbrojtja ka kundërshtuar se të dy aktgjykimet tregojnë mospërputhje në mes të dispozitivit dhe arsytimit dhe se i mungojnë bazat e fakteve materiale në lidhje me aktet e Mashtrimit të pretenduar të kryer nga i pandehuri. Prandaj, neni 403 paragrafi pika 12 e KPPK-së është shkelur.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se as aktgjykimi i shkallës së parë e as i shkallës së dytë nuk përmbajnë shkelje esenciale të nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së



**Dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale** në veçanti përmban të gjitha kushtet formale të përcaktuara me ligj sipas nenit 396 paragrafëve 3 deri 5 në lidhje me nenin 391 të KPPK-së dhe në mënyrë të qartë thekson secilën pikë dhe përmend veprimet përkatëse penale për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor, dhe pastaj – në kontekst të caktimit të dënimit unik - liston në detaje se si është llogaritur ky dënim në bazë të secilës vepër penale të kryer nga i pandehuri.

Dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës Komunale është gjithashtu në përputhje të plotë me arsyetimin e aktgjykimit, dhe kjo e fundit është e qartë dhe në përputhje me brendinë. Veçanërisht, në lidhje me provat në pikat II dhe III të aktgjykimit për Mashtrimin e kryer nga i pandehuri, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar në tërësi të gjitha provat në dispozicion dhe i ka analizuar plotësisht deklaratat e të gjithë dëshmitarëve e posaçërisht ato të F. [ ] M [ ] dhe F [ ] K [ ] : (faqet 7-11 të versionit në gjuhën angleze).

Argumentet e avokatit mbrojtës se nuk ka asnjë provë në arsyetim lidhur me të pandehurin për ndërmarrjen e qëllimshme të veprave konkrete të inkriminuara janë jomeritore dhe të pabazuara. Edhe pse gjykata në mënyrë të qartë ka theksuar se në të gjitha rastet i pandehuri ka vepruar me qëllim të përfitimit dobisë pasurore të kundërligjshme, në këtë lëndë nënkuptohet se veprimet përkatëse të pandehurit siç janë përshkruar nga dëshmitarët dhe pastaj janë vërtetuar nga gjykata nuk mund të jenë kryer nga neglizhenca, mirëpo dashja ka qenë e nevojshme.

Përfundimisht, Gjykata Supreme konstaton se avokati mbrojtës nuk paspecifikuar asnjë aspekt tjetër për mungesë ose prova të pamjaftueshme në kontekstin e dhënë.

**E njëjta vlen edhe për aktgjykimin e shkallës së dytë.** Dispozitivi i saj është e qartë në lidhje me veprat penale gjithashtu të aprovuara në pjesën e aktgjykimit të shkallës së parë, e cila është anuluar dhe është kthyer në rigjykim. Gjithashtu vendimi mbi dënimin i aktgjykimit të shkallës së dytë është i qartë. Gjykata pa asnjë dyshim ka theksuar se nga dënimet e ndara të pjesëve të pranuar të aktgjykimit të Gjykatës Komunale është caktuar një dënim unik i ri dhe i zvogëluar. Gjithashtu këtu, dispozitivi plotësisht përputhet me arsyetimin e aktgjykimit.

Arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës së Qarkut është i qartë dhe në përputhje me brendinë. Në mënyrë shumë të saktë gjykata e shkallës së dytë ka theksuar çfarë dhe pse Gjykata Komunale ka vlerësuar në mënyrë të duhur të gjitha provat dhe gjetur në vendim të pranueshëm për pikat II dhe III të aktgjykimit për Mashtrimin e kryer nga i pandehuri. Gjykata e shkallës së dytë gjithashtu ka sqaruar në mënyrë të qartë arsyet e veta për anulimin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale në lidhje me pikat Dhënia e kundërligjshme e ndihmës juridike sipas nenit 336 të KPPK-së, duke theksuar se Gjykata Komunale ka konsideruar se i pandehuri ka kryer veprën penale përkatëse në vazhdimësi, gjë që kjo e fundit nuk është e rregulluar me ligj dhe

prandaj është një çështje e praktikës juridike. Kjo si pasojë mund të shpie në një dënim edhe më të ashpër ndaj të pandehurit nën pikën I të aktgjykimeve të kundërshtuara.

Në të dy rastet, dispozitivi thekson në mënyrë të qartë cilësimin juridik dhe veprat për të cilat Ramadan Sylejmani është shpallur fajtor si dhe dënimin e shqiptuar.

Gjykata Supreme për më tepër gjen se dispozitivi i të dy aktgjykimeve është plotësisht i mbështetur me gjetjet faktike dhe vlerësimin e provave siç është dhënë në arsyetimin përkatës.

E fundit por jo më pak e rëndësishme Gjykata Supreme e Kosovës i referohet gjykimin të saj të përhershëm sipas të cilit “është trupi gjykues ai i cili dëgjon, vlerëson dhe peshon që provat në gjykim [dhe se] prandaj, trupit gjykues [duhet patjetër t’i jepet] hapësirë për vlerësim të lirë në arritjen e gjetjeve saj faktike”. Nuk duhet t’i çrregullojë gjetjet e trupit gjykues për t’i zëvendësuar me të vetat, përveç nëse provat në të cilat është mbështetur trupi gjykues nuk do të pranoheshin nga asnjë gjykatë e arsyeshme e fakteve, ose kur vlerësimi i tyre ka qenë “tërësisht i gabuar” siç është përcaktuar në lëndën *Runjeva, Akgami dhe Dema (Gjykata Supreme e Kosovës AP-KZ 477/05 i datës 25 janar 2008, f.20 (versioni në anglisht)* dhe është përsëritur dhe zhvilluar më tutje në mes tjerash në këndën kundër Florim Ejupit (*Gjykata Supreme e Kosovës Pkl-Kzz 71/09 i datës 10 tetor 2009*) dhe kundër Jeton Kiqinës (*Gjykata Supreme e Kosovës, Ap.-Kz. Nr. 84/2009 i datës 03 dhjetor 2009*).

**bb. Shkeljet e pretenduara të nenit 403 paragrafit 1 pikës 8 të KPPK-së:**

I pandehuri ka kundërshtuar të dy aktgjykimet duke pohuar se Polici i Hetuesisë Mr. J. K. gjatë marrjes së deklaratave në Polici nga dëshmitarët M. A. dhe I. K. i ka shantazhuar dhe kërcënuar që të dy, duke ju thënë se do t’i dërgonte në burgun e Dubravës nëse nuk i ndryshojnë deklaratat e tyre, dhe në vend të tyre të deklarojnë atë që Polici ju ka thënë të deklarojnë. Pasi që të dy gjykatat kanë përcjell të dy dëshmitarët, ato kanë shkelur nenin 403 paragrafin 1 pikën 8 si dhe nenet 153, 155 paragrafin 1 pikat 1 dhe 3 dhe 161 pikën 4 të KPPK-së

Referencë i bëhet asaj që tanimë është thënë në lidhje me vlerësimin e provave të bërë nga Gjykata Komunale në Prizren dhe se Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka zëvendësuar provat siç është vlerësuar nga trupi gjykues.

**cc. Shkelja e pretenduar e nenit 404 pikës 1 të KPPK-së:**

Për më tepër, i pandehuri në Kërkesën e tij për Mbrojtjen e Ligjshmërisë pohon se Gjykata e Qarkut në Prizren ka shkelur nenin 404 pikën I të KPPK-së, kur ka vërtetuar dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë për pikat I dhe III të aktgjykimin përkatës, e cila është për Mashtrim sipas nenit 261 paragrafëve 1 dhe 2 të

KPK-së. Gjykata në veçanti nuk e ka marrë parasysh se dëshmitarët Fatmire Krasniqi dhe Ragip Mihalica - siç kanë pranuar me shkrim – kanë deklaruar se në veçanti Ragip Mihalica ka dhënë deklaratë të gabuar pranë gjykatës së shkallës së parë pasi që ka qenë i manipuluar nga Polici M. ... t J ... dhe se F ... ; K ... ka vërtetuar me shkrim se çfarëdo që kanë bërë ajo dhe H ... ; S ... ka qenë në bazë të marrëveshjes me të pandehurin.

Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se të dy dëshmitarët kanë qenë shumë të qartë dhe pa asnjë dyshim në lidhje me të gjitha faktet përkatëse.

**Dëshmitari R ... M ...**, i cili në fakt është kompensuar nga kompania e sigurimeve “Siguria” në shumë prej 12.198,- Euro, – sa i përket rëndësisë së kësaj në kontekstin e dhënë – ai deklaroi si në vijim:

*“Herën e parë ku ai [i pandehuri] ka ardhur në shtëpinë time, i pandehuri Ramadan Sylejmani nuk është prezantuar s prokuror por si avokat. [ ... ] Është e vërtetë se Ramadani i ka sjellë paratë në shtëpinë tonë dhe për këtë më ka treguar motra ime Hebibja dhe se shuma [ ishte ] vetëm 6000Euro (gjashtëmijë Euro). Unë kam mësuar për këtë sapa ka ardhur në shtëpi nga puna, mirëpo në atë moment unë nuk kam qenë i pranishëm aty. Në shtëpinë tonë, ne nuk e dimë sa para na janë ndarë nga kompania e sigurimeve mirë por [lidhur me] shumën prej 6000 Euro të cilat ai i ka sjellë në shtëpinë tonë, i pandehuri Ramadan Sylejmani na ka thënë se “kjo është shuma e cila ju është ndarë”. Unë nuk e di cila shumë na është ndarë nga kompania e sigurimeve për kompensimin e dëmit në emër të vëllait tim, përkatësisht unë nuk e di shumën e parave. [...] Është e vërtetë se Ramadan Sylejmani së bashku me gruan e tij H ... ish in këtu në shtëpinë time dhe më kanë thënë se “Ti duhet të thuash se i ke marrë te gjitha paratë dhe këtë duhet t’ia thuash Policisë”. Kurse herën e dytë kur i pandehuri Ramadani me gruan e tij H ... kanë ardhur i kanë thënë familjes tonë se “Nëse Ramadani shkon në burg për këtë punë ju duhet t’i ktheni ato 6000 Euro të cilat ai ua ka dhënë juve” (dëshmia e dëshmitarit R ... M ... a e datës 25 shkurt 2010, f.1 e versionit në gjuhën angleze).*

Dëshmitari në kontekstin përkatës më tutje ka deklaruar se e tërë situata ka ndodhur si rezultat i aksidentit të trafikut të vëllait të tij dhe në lidhje me kërkesën për kompensim kundër kompanisë së sigurimeve. Përveç kësaj, pasi që dëshmitari kishte raportuar në Polici se atij në rrugë i ishte ofruar një mik i të pandehurit, i cili i kishte kërkuar që të shkojë përsëri në Polici dhe ta ndryshoj deklaratën e tij. Sidoqoftë, dëshmitari pranë Gjykatës ka nënvizuar se ai asnjëherë nuk e kishte bërë këtë dhe ai gjithmonë do të qëndrojë pranë deklaratës së dhënë.

**Dëshmitarja F ... K ...** – sa i përket rëndësisë së kësaj në këtë kontekst – më 08 prill 2010 ka deklaruar pranë Gjykatës si në vijim:

*“[n] e kemi pasur aksident trafiku ku unë kam pësuar lëndime trupore. Më kujtohet emri i personit H ... dhe ajo është gruaja e Ramadan Sylejmanit, të akizuarit.*

Unë nuk e kam njohur Ramadan Sylejmanin. Një ditë jam takuar me I. [..] të cilën e kam njohur përpara dhe siç ishim duke biseduar e njëjta më pyeti çfarë të ka ndodhur dhe unë i thash se kam pasur një aksident trafiku dhe kam pësuar lëndime trupore, dhe pastaj ajo më pyeti a je kompensuar për këtë, unë i thashë jo, ajo më tha se mund të nxirrte kompensimin nga kompania e sigurimeve. Atë ditë jam takuar me H. [..] dhe e kemi pasur këtë bisedë, e njëjta më ka ofruar ndihmë për marrë parate nga kompania e sigurimeve. [...] Unë jam kompensuar materialisht nga kompania e sigurimeve dhe i kam pranuar paratë nga H. [..] Është e vërtetë se Hamija ka ardhur në shtëpinë time dhe i ka sjellë paratë në shumë prej 13.000 Euro. Në atë ditë ajo i ka sjellë paratë në shumë prej 13.000 Euro dhe më ka pyetur nëse do të mund t'ia jepja 7.000 Euro dhe se ato do t'i kthente pas disa ditëve. [...] Një ditë, nuk më kujtohet data në shtëpinë time kanë ardhur Policët nga Stacioni i Policisë në Ferizaj dhe kanë kërkuar që të shkoj në stacionin e policisë për të dhënë deklaratë lidhur me paratë që i kam marr në emër të kompensimit të dëmit nga aksidenti në trafik. [...] Gjatë bisedës me H. [..] ajo më ka thënë që të shkojë në stacionin e policisë dhe të sqaroj ashtu siç kemi biseduar, se i kam marrë 13.000 Euro nga Hamija kurse shumë e mbetur prej 7.000 Euro ajo ma kishte borxh dhe se do të mi kthente një ditë tjetër. Gjatë bisedës telefonike H. [..] më ka ofruar që ta angazhoj një avokat për mua dhe më ka thënë se nëse dëshiroj ta bësh këtë, avokati po të pret në kafën "Goges", dhe unë u përgjigja pozitivisht, përkatësisht i kam thënë se nuk kam asgjë kundër nëse ajo dëshiron që të angazhoj avokat për mua. Mirë po unë mendoj se ajo dëshiron që ta kem avokatin të pranishëm gjatë dhënies së deklaratës në polici. [...] Më kujtohet shumë mirë që policët i kanë thënë avokatit se nuk ke nevojë të qëndrosh gjatë marrjes në pyetje dhe i njëjti është larguar nga zyra, kurse unë kam vazhduar me deklaratën. Gjatë gjithë kohës së deklaratës vëllai im A. M. [..] ka qenë i pranishëm. [...] Në pyetjen e gjykatës, e njëjta ka deklaruar se e di shumë e parave e cila më takon nga kompensimi dhe është në shumë prej 20.000 Euro. [...] Në momenti që më janë dhënë paratë, ai nuk ka treguar ndonjë dokument lidhur me shumë me të cilën jam kompensuar nga kompania e sigurimeve. Është e vërtetë se unë e kam nënshkruar autorizimin në zyrën e avokatit në Ferizaj, mirëpo nuk ia di emrin. Me sa e di unë i kam dhënë autorizimin me nënshkrimin e të njëjtit për H. [..]. [...] Në pyetjen e mbrojtjes, [...] e njëjta ka deklaruar se deri më sot ai nuk mi ka kthyer ato 7.000 Euro"

Gjykata Komunale në Prizren, ka vlerësuar në tërësi deklaratën e dhënë nga dëshmitarja dhe ka theksuar në detaje, pse dhe në lidhje me çka deklaratat e dëshmitares janë konsideruar të besueshme, dhe pse kjo në pjesët tjera është vlerësuar ndryshe. Për më tepër, Gjykata – e konsideron këtë vendimtare – ka konstatuar se urdhëresa për pagesë e kompanisë së sigurimeve "Siguria" nr. 1351/2006, e datës 29 nëntor 2006 dhe në dobi të dëshmitares f. [..] K. [..], e ka transferuar shumë për kompensim prej 20.000 Euro në xhirollogarinë bankare nr. 1407000006189061 në Bankën Ekonomike, e cila ishte në emër të të pandehurit Ramadan Sylejmanit. Gjykata ka konstatuar se shumta e parave në fjalë është tërhequr përsëri nga xhirollogaria bankare më 20 dhjetor 2006 (Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, faqe 11, versioni në gjuhën angleze).

Gjykata e Qarkut në Prizren ka analizuar arsyetimin e shkallës së parë në detaje dhe ka gjetur se në lidhje me pikat II dhe III të aktgjykimit të kundërshtuar, i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës nuk mund të dëgjohen me ankesat e tyre. Gjykata e Qarkut ka gjetur se pretendimet e të pandehurit dhe avokatit mbrojtës siç janë cekur këtu, në veçanti se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht nga Gjykata Komunale dhe si pasojë vlerësimi i provave në shqyrtimin gjyqësor si dhe në përfundimin e gjykatës në lidhje me faktet vendimtare janë të gabuara dhe jo të plota, janë të pabazuara. Gjykata e Qarkut në arsyetimin e saj i referohet fakteve të vërtetuara përkundër dëshmimeve të dëshmitarëve, që janë shumat e parave të paguara nga kompania e sigurimeve "Siguria" në njërën anë dhe shumat e dorëzuara të dëshmitarët nga i pandehuri në anën tjetër (Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut, faqe 4 versioni në gjuhën angleze).

Natyrisht, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se Gjykata e Qarkut në Prizren nuk ka verifikuar besueshmërinë e dëshmitarëve Ferizaj, Ramadan Sylejmani dhe Ramadan Sylejmani në pretendimet e ngritura nga Mbrojtja dhe i pandehuri në rrjedhën e ankesës së tyre ndaj Policisë të Kosovës Mbrojtja, që ky i fundit ka ndikuar në dëshmitarët të ndryshojnë dëshmitë e tyre të dhëna para policisë. Sa i përket kësaj është e rëndësishme se i pandehuri, i cili në ankesë ka akuzuar Muhamet Jahirin se është kriminel i njohur që ka për qëllim t'i bëjë keq të pandehurit, ka ngritur pretendime të ngjashme prapë në Kërkesën e tij për Mbrojtje të Ligjshmërisë.

Gjykata Supreme e Kosovës në kontekstin e dhënë gjen se është vendimtare të përsëritet se kontestimi i aktgjyqimeve për shkak të gjendjes faktike është i papranueshëm në përputhje me Nenin 451 (2) të KPPK-së. Megjithatë, Mbrojtja pikë së pari mund të ketë dashur ta kundërshtojë besueshmërinë e dëshmitarit përkatës dhe kështu edhe pranueshmërinë e provave sipas Nenit 403 paragrafit 1 pikës 8 të KPPK-së.

Pas kontrollimit të dëshmimeve të dëshmitarëve Ferizaj, Ramadan Sylejmani dhe Ramadan Sylejmani siç janë dhënë para Policisë përkatës të Kosovës Mbrojtja, Gjykata Supreme e Kosovës vërtetoi si në vijim:

**Dëshmitari Ramadan Sylejmani** ka dëshmuar më 15 maj 2008, duke thënë se "...një kushëri i imi më njoftoi me një avokat me emrin Ramadan Sylejmani nga Ferizaj, Ramadanani erdhi në shtëpinë tonë dhe më tha nëse do [unë] t'i marrësh paratë ne duhet t'i ndajmë përgjysmë, unë i thashë se nuk kam para për të dhënë ty, ai tha ti do të mi japësh paratë kur t'i marr ato, pas një muaji gjersa isha në punë avokati Ramadan Sylejmani erdhi në shtëpinë tonë dhe ia dha motrës sime H... s 6000 Euro (gjashtëmijë euro), ne i shfrytëzuam këto para për ilaçe për ta shëruar vëllanë tonë Ar..., por ato nuk mjaftonin kështu që i shtuam edhe ca para tona, por prapëseprapë vëllai ynë nuk është mirë" dhe se "[n]jëherë para se t'i marrim paratë unë shkova ta pyesja atë [të pandehurin] çka kishte ndodhur me lëndën, dhe ai më tha se vëllait tim i takojnë vetëm 6000 Euro. Unë i thashë se atij së më duken shumë pak, dhe ai më tha që këto janë të gjitha. Ai na tha se ai kishte marrë pranuar vetëm 6000 Euro".

**Dëshmitarja F** **K** **qi** ka përshkruar situatën edhe më keq se që e kishte përshkruar para Gjykatës Komunale në Prizren, kur më 10 korrik 2008 deklaroi se "[n]ë shkurt të këtij viti H. : ordhi te unë dhe mi solli paratë e mija dhe tha që kishte arritur të merrte vetëm 13000 euro jo më shumë dhe unë i morra paratë në shtëpinë time në prani të fëmijëve të mi të vegjël 2 vjeç. Unë isha kënaqur që morra paratë dhe falënderova H. dhe e pyeta nëse donte ta paguaja të por ajo tha që nuk kishte nevojë, vetëm një drekë t'ia paguaja ndonjëherë nëse doja. Unë nuk e di sa para ka tërhequr H. në emrin tim, por unë i morra vetëm 13000 euro dhe nuk di asgjë për paratë tjera". Përveç kësaj, "...para një muaji apo më shumë ajo [ ] ishte në shtëpinë time dhe më tha nëse policia pyesin për paratë unë duhet të thosha 20000 euro por jo vetëm 13000 sepse ajo tha që do të më jepte pjesën e mbetur të parave që e kishte mbajtur".

Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës gjen se nuk ishte nevoja që Gjykata e Qarkut në Prizren të kontrollonte pretendimet e të pandehurit se Polici i Kosovës M. kishte ndikuar në dëshmitarët për të ndryshuar dëshmitë e tyre para Gjykatës. De facto, dëshmitarët qartazi nuk kanë ndryshuar dëshmitë e tyre e dhëna në polici, kur ishin ftuar të dëshmojnë para Gjykatës Komunale në Prizren.

Në këtë kontekst po ashtu duhet të theksohet se të dy dëshmitarët gjatë dëshmimit të tyre para Gjykatës Komunale ishin pyetur rreth kërkesave të pretenduara të të pandehurit për të ndryshuar dëshmitë e tyre. Ata deklaruan se nuk ishte ashtu. Përkitazi me këtë, dëshmitë me dorëshkrim të dëshmitarëve përkatës siç u prezantuan nga i pandehuri, pa marrë parasysh pyetjen, se a janë vërtetë nga dëshmitarët, nuk e shtyjnë Gjykatën Supreme të marrë vendim që të gjitha dëshmitë të ri-konsiderohen prapë.

Siç është potencuar tanimë dy herë në këtë Aktgjykim, Gjykata Supreme nuk i zëvendëson dëshmitë e vlerësuara nga instancat e gjyqimit.

## **b. Shkeljet e ligjit penal:**

### **aa. Shkelja e ligjit penal përmes shkeljes së procedurës penale:**

Mbrojtja ka kundërshtuar se të dy Aktgjykimet shkelin ligjin penal në përgjithësi në dëm të të pandehurit, pasi që rrethanat dhe dëshmitë për përjashtimin e përgjegjësisë penale të të pandehurit nuk ishte marrë parasysh. Prandaj, në veçanti Neni 408 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së janë shkelur.

Pavarësisht se Neni 408 paragrafi 1 dhe 2 i KPPK-së që Mbrojtja i referohet nuk ekziston dhe dispozita e vërtetë e Neni 408 të KPPK-së vendos mbi dorëzimin e një kopjeje të ankesës palës së kundërt, që kjo e fundit nuk ka lidhje me këtë lëndë, referimi është bërë për atë se çka ishte potencuar më parë në pikën a. të këtij Aktgjykimi lidhur me shkeljen e pretenduar të procedurës penale. Pasi u konstatua se

asnjë shkelje esenciale e procedurës penale nuk mund të vërtetohet, argumenti i Avokatit mbrojtës në kontekstin e dhënë është po ashtu pa meritë.

**bb: Shkelja e Neneve 1 dhe 3 të KPK-së:**

I pandehuri është i mendimit se të dy Gjykatat ajo Komunale dhe e Qarkut në Prizren kanë shkelur Nenet 1 dhe 3 të KPK-së, që ndalon nxjerrjen e analogjive në fushën e ligjit penal dhe kërkon që në rast të dykuptimisë vepra penale të interpretohet në dobi të të pandehurit.

Referenca është bërë ndaj asaj çka u potencua tanimë më parë. Gjykata Supreme gjen se sikur Gjykata Komunale në Prizren ashtu edhe Gjykata e Qarkut në Prizren ka përfshirë drejt veprimet e të pandehurit nën ligjin penal dhe asnjë analogji e ndaluar nuk mund të identifikohet fare. Kjo madje i adresohet faktit që Gjykata e Qarkut ka anuluar Aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket pikës I dhe ka kthyer lëndën për rigjykim. Siç është theksuar më herët, anulimi nuk është bërë për shkak të zbatimit jo të drejtë të ligjit material penal nga Gjykata Komunale, por duke marrë parasysh faktin se veprimet e të pandehurit janë konsideruar si të kryera në vazhdimësi.

**cc: Shkelja e Nenit 6 të KPK-së:**

I pandehuri në fund është i mendimit se veprimet përkatëse të ndërmarra nga i pandehuri nuk përputhen me kushtet e veprës penale për të cilën ai është shpallur fajtor.

Referencë është bërë ndaj asaj çka është vërtetuar tanimë më parë në këtë Aktgjykim. Gjykata Supreme e Kosovës nuk gjen asnjë zbatim të gabuar të ligjit material penal e asnjë dështim për të përfshirë drejt faktet sipas ligjit siç është vepruar nga ana e Gjykatës Komunale dhe Gjykatës së Qarkut.

**III. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës**

Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës përfundon se Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë është e pabazuar dhe prandaj refuzohet, kurse të dy Aktgjykimet ai i Gjykatës së Qarkut në Prizren si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren të mbështetur në Shkallë të dytë vërtetohen.

Për këtë shkak, zbatimi i Aktgjykimeve nuk ndërpritet deri në vendimin e plotfuqishëm, siç është propozuar nga i pandehuri.

Rrjedhimisht, Gjykata Supreme e Kosovës vendos si në dispozitiv mbi Kërkesat përkatëse për Mbrojtje të Ligjshmërisë të këtij, në bazë të Nenit 457 paragrafi 1 pika 2 e KPPK-së.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
Pkl-Kzz 69/2010, data 03 maj 2011

**Kryetari i Kolegjit:**

\_\_\_\_\_  
Gerrit Marc-Sprenger  
Gjyqtar i EULEX-it

**Procesmbajtësi:**

\_\_\_\_\_  
Adnan Isufi  
Këshilltar Ligjor


**Anëtarët e Kolegjit:**

\_\_\_\_\_  
Emine Mustafa  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

\_\_\_\_\_  
Marije Ademi,  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

**Mjeti Juridik:**

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë (Neni 451 paragrafi (2) i KPPK-së).



Kryetari i Kolegjit  
Gjykatës Supreme të Kosovës

BAJTI I SINE E KURJES E VËRSETON  
YKONOST OTPRAMKA PUTVODIJE

Proçesmbajtës  
Gjykatës Supreme të Kosovës

*[Handwritten signature]*